

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit N. K. nga fsh. V., Komuna Lipjan, të cilën e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.2591/17 të dt.08.05.2017, për shkak të veprës penale Vjedhe nga neni 325 par. 1 të KPRK-së, në shqyrtim gjyqësor publik, të mbajtur me dt.24.05.2018, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit E. J., dhe të akuzuarit, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

N. K., i biri i F. dhe A., e gjinisë N., i lindur me dt.*data e lindjes...*, nga fshati V., K. Lipjan, i pamartuar, ka të kryer Shkollën e mesme, student, me gjendje të mirë ekonomike, me nr. personal *numri përsonal...*, Shqipëtarë, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse :

Me datë 22.02.2017, rreth orës 21.00, në fshatin D. e M., Komuna Lipjan, i pandehuri, me veturën e tij të tipit “Opel Astra karavan”, ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, me qëllim të përvetësimit të pasurisë së lujtshme që vetës t’i sjellë dobi pasurore, në mënyrë të kundërligjshme, nga shtylla e rrjetit elektrik ka arritur të marrë tri pajisje për përforcimin e rrjetit të internetit “Aplifikato-përforcues”, pronë e tani të dëmtuarës “Kompania K.”, me ç’rast i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 525.-€

-me këtë ka kryer veprë penale Vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së

Andaj gjykata konform neneve 1,2,4,6,41,42,43,46,49,50,51,52 dhe nenit 325 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, e gjykon:

ME DËNIM ME KUSHT DHE ME GJOBË

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale, dhe

Me dënim me gjobë në shumë prej 300.-€, (treqindëeuro), të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në qoftëse dënimi me gjobë nuk paguhet në afatin e caktuar, konform nenit 46 të KPRK-së dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim ku do të llogaritet shuma prej 20 €.- për një ditë burgimi.

I dëmtuari- Perfaqësuesi i Kompanisë “K.”, udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizojë në procedurë të rregulltë gjyqësore.

DETYROHET i akuzuari që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të i’a paguajë shumën prej 20.-€, Fondin e viktimave të krimit 30.-€, këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.2591/2017 të dt.08.05.2017 e ka akuzuar të pandehurin N. K. nga fsh. V. K. Lipjan, për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par. 1 të KPRK-së.

Prokurorja e shtetit në shqyrtimin fillestar deklaroi se e pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit sepse një pranim i tillë është i mbështetur në provat që i përmban akti akuzues dhe i propozon gjykatës që të njejtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I pandehuri ka deklaruar se e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe njëherë ka shtuar se ditën kritike ka qenë i provokuar nga e dëmtuara dhe asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin, i ka propozuar gjykatës që t'i shqipton një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi që bindet se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore e as gabime faktike, konform nenit 248 të KPRK-së, e pranoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale Vjedhje nga neni 325 par. 1.4 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, sjelljen para kryerjes se veprës penale, pra faktin se i pandehuri për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, sjelljen e të pandehurit pas kryerjes se veprës, pra sjelljen gjatë shqyrtimit gjyqësor, premtimin e dhënë kësaj gjykate se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla të ngjashme, e veçanarisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndersa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit ashtu që i njëjti në kohën e kryerjes se veprës penale ka qenë i aftë plotësisht për të kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta si dhe shkallën e rrezikshmerisë së veprës penale konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtit i shqiptoj dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 41 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të bëjë kompenzimin e palës së dëmtuar si dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit si dhe konform nenit 50 të KPRK-së, që parasheh që dënimi të mos zbatohet për veprat e lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryej vepra penale.

Vendimi për paushallin gjyqësor u bazua në nenin 450 par.1 dhe 2 nën par. 6 të KPRK-së ndersa vendimi për pagesën në fondin e viktimave u bazua në nenin 39 të Ligjit për mbrojtjen e viktimave.

Vendimi mbi realizimin e kërkesës pasurore-juridike u bazua konform nenit 463 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN.

P.nr.2591/2017 me dt.08.05.2017

Sekretarja juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate